



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 16.12.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9918 , DATË 19.5.2008,
“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 22.11.2019, 25.11.2019, 6.12.2019, 11.12.2019 dhe 16.12.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Relatore për shqyrtimin e projektligjit u caktua deputetja Klotilda Bushka (Ferhati).

Në mbledhjet e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishin të pranishëm: zëvendësministria e Drejtësisë znj. Fjoralba Caka, përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), z. Gentian Sala dhe përfaqësues nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. ARSYET PËR NDËRHYRJE LIGJORE

Ligji nr.9918/2008, “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, i ndryshuar, është aktualisht ligji kuadër procedural dhe material, që përcakton normat dhe procedurat mbi rregullimin e fushës së komunikimeve elektronike me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në territorin e RSH. Bazuar në ligj, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike (AKEP) është përcaktuar si organi i vetëm rregullator që administron domain nën.al.

Duke ditur se fusha e teknologjisë së informacionit është një sektor tepër dinamik, kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon asnjë rregullim për veprimtarinë e subjekteve të ndryshme që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet portaleve online, si dhe as nivelin e koordinimit midis institucioneve përgjegjëse dhe pjesëmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

Në këto kushte, duke mbajtur në fokus veçanërisht ndikimin e portaleve online gjatë viteve të fundit është e nevojshme që të ndërmerret një rregullim ose normim i procedurave që duhet të ndiqen nga institucionet përgjegjëse me qëllim sigurimin/respektimin e kufizimeve sa i përket materialeve me përmbajtje të paligjshme, ose të dëmshme, ose në kuadër të luftës kundër piraterisë online, si dhe rregullimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve online.

III. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHET TË ARRIHEN

Ky projekt ligj është pjesë e paketës së projektligjeve të propozuara nga qeveria së bashku me projektligjin për shtesa dhe ndryshime në ligjin në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Projektligji ka për qëllim reflektimin e ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me rregullimin e shërbimeve të publikimeve elektronike, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare dhe dezinformimit, përhapjes së lajmeve të rreme, cënimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, probleme që hasen gjerësisht edhe në vendet e tjera dhe jo vetëm në Shqipëri.

Mediat elektronike (on-line), për shkak edhe të lehtësisë së aksesit të çdo individi dhe përdorimit të portaleve on-line nga një numër i pakufizuar personash, kanë një tendencë në rritje dhe po zëvendësojnë mediat tradicionale.

Për të mbrojtur veçanërisht dinjitetin dhe reputacionin e individit, të miturit nga përmbajtjet e dëmshme dhe të gjithë qytetarët nga nxitja ndaj urrejtjes, dhunës etj. propozohet amendimi i këtij ligji, si një nismë e domosdoshme mbështetëse për zbatimin efikas të ligjit për mediat audiovizive, i cili parashikohet të përfshijë në objektin e tij edhe rregullimin e mediave elektronike.

Gjithashtu, vlen të theksohet se, pavarësisht nga ndryshimet e propozuara, ky projektligj në asnjë dispozitë të tij nuk cënon lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizive dhe elektronike, por synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike në mënyrë që të respektohen dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e diskursit publik.

Objektivat që projektligji synon të arrijë:

- 1) Të rregullohet koordinimi midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve dhe ofruesve të shërbimeve të publikimeve online;
- 2) Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;
- 3) Të garantohet e drejta e informimit dhe lirisë së shprehjes;
- 4) Të mos lejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme, si dhe materialet me përmbajtje të paligjshme.

IV. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji është shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit të tij. Bazuar në analizën e këtij raporti, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave, projektligji parashikohet të ketë këto efekte për:

- a) **Poseduesit që kanë domain nën.al**, të cilët aktualisht arrijnë në 23 000 mijë të tillë, si dhe ata që **nuk posedojnë domain ose nëndomain nën.al**, por që janë të regjistruar pranë organeve kompetente dhe zhvillojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë.
- b) **AKEP** është organ publik i pavarur, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit e për rrjedhojë projektligji nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për buxhetin e shtetit. Të gjitha sistemet elektronike janë të ngritura pranë AKEP, dhe stafi është i kualifikuar për të përballuar funksionet e atribuara me ndryshimet përkatëse ligjore që priten të miratohen. Parashikohet shtimi i kostove administrative të AKEP në kuadër të krijimit, verifikimit dhe mirëmbajtjes së të dhënave apo regjistrave për subjektet të cilët kanë në posedim domaine jashtë regjimit të domaneve nën .al, si dhe të pjesës së stafit teknik që do të bashkërendojnë punën me ISP-të për marrjen e masave administrative dhe teknike për zbatimin e vendimeve të AMA-s. Natyrisht, këto kosto do të përballohen nga AKEP nëpërmjet buxhetit të tij.

V. PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji përmban 5 nene. Sikurse e theksuam edhe më lart, ndryshimet në këtë ligj vlerësohen të hamonizuara me shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

- Projektligji jep përkufizimet e koncepteve “ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike” dhe “publikimi elektronik” që kanë të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë
- Në një nga kompetencat e AKEP, në ligjin në fuqi, për të administruar domain cc.TLD.al dhe nëndomainet e tij, shtohet edhe përcaktimi me rregullore të posaçme i rregullave të hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.”.
- Në kompetencën e AKEP për të marrë masat, që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendjeje të jashtëzakonshme, shtohet edhe *garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit si dhe çdo detyrim të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”.*
- Në fushën e bashkëpunimit të AKEP-it shtohet edhe bashkëpunimi me AMA-n në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.”. .
- Në nenin 137 të ligjit në fuqi i cili parashikon gjobat, propozohet që edhe për ofruesit e shërbimit të komunikimeve publike, të cilët nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4, të këtij ligji, të parashikohet dënimi me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

VI. TRANSPARENCA DHE KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji është konsultuar vazhdimisht me ekspertët ndërkombëtarë të OSBE-së dhe është rishikuar disa herë nën dritën e komenteve dhe sugjerimeve të tyre dhe nga grupi i punës i përbërë nga relatorët e dy komisioneve “Për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” dhe “Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik” me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë.

Krahas konsultimit me ekspertët e OSBE-së, është zhvilluar një proces i gjerë konsultimi dhe në tryezat e konsultimit publik të zhvilluara nga komisioni sipas një kalendarit të posacëm të miratuar në datën 11.11.2019 për shqyrtimin e dy projektligjeve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 dhe “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar¹.

Kështu, bazuar në kalendarin e miratuar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, komisioni organizoi seancat dëgjimore si më poshtë:

Në datën 25.11.2019 komisioni zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerëve ndërkombëtarë. Morën pjesë përfaqësues nga: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Prezenca e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Avokati i Popullit, Delegacioni i Bashkimit Evropian, Agjensia e Zhvillimit Ndërkombëtar (USAID), Prezenca e Këshillit të Evropës, Prezenca e Bashkimit Evropian për të Shurdhër. Nga operatorët mediatikë nuk pati pjesëmarrje.

Në datën 10.12.2019 komisioni zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Morën pjesë përfaqësues nga: Exit Neës, Shoqata e Avokatëve Penalistë, Faktoje.al, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, National Democratic Institute (NDI), Res Publika, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Birn Albania. Nga dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit nuk pati pjesëmarrje.

Në datën 11.12.2019 komisioni zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të botës akademike, fushës së gjyqësorit, prokurorisë, avokatisë dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve. Morën pjesë përfaqësues nga: Prokuroria e Përgjithshme, Fakulteti i Drejtësisë, dhe gazetarë/ë.

Komentet e marra nga pjesëmarrësit, si gjatë konsultimeve publike, ashtu dhe kontributet e dhëna me shkrim, janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mbledhjet e grupit të punës dhe janë reflektuar në tekstin e projektligjit.

VII. DISKUTIME DHE NDRYSHIME TË MIRATUARA NË KOMISION

Gjatë diskutimit në parim u theksua nevoja e miratimit të kësaj nisme me qëllim reflektimin e ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me rregullimin e shërbimeve të publikimeve elektronike, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare dhe dezinformimit, përhapjes së lajmeve të rreme,

¹<https://ëëë.parlament.al/Files/ProgramiPunes/Kalendar%20seancat%20degjimore%20per%20paketen%20antishpifje%20FINAL.pdf>

cënimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, probleme që hasen gjerësisht edhe në vendet e tjera dhe jo vetëm në Shqipëri.

Gjatë shqyrtimit nën për nën të projektligjit, Komisioni miratoi ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Të hiqet shkronja “rr” e nenit 2 të projektligjit, e cila ndryshon shkronjën “rr” të nenit 8 të ligjit në fuqi. *(propozimi i ekspertëve të OSBE-së)*
2. Në pikën 2/1 të nenit 4 të projektligjit togfjalëshi “shërbimit të komunikimeve publike” të zëvendësohet me “shërbimit të komunikimeve elektronike”

Gjithashtu, komisioni, bazuar në propozimin e përfaqësuesve të AKEP-it, i përcjell komisionit përgjegjës për vlerësim unifikimin e gjobave me gjobat e aplikuara nga AMA

VIII. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe garantimin e lirisë së shprehjes.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relatore vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORE

KLOTILDA BUSHKA

KRYETAR

ULSI MANJA